



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**



---

**KOMISIONERI**

Nr. 1746 Prot.

datë 30.10 2020

**NJOFTIM**

Për vënie në lëvizje të KOMISIONIT RREGULLATOR

**Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës “c”, të paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka përgatitur projektvendimin “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. Në mbështetje të shkronjës “e”, paragrafi 1, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrtimi dhe miratimi i këtij projektvendimi është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Përsa më sipër, në respekt të këtij parashikimi ligjor propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektvendimit dhe të relacionit shoqërues.

Materialet e mbledhjes ju vihen në dispozicion nga sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t’i gjeni në faqen e KQZ-së në internet [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al) në rubrikën e Njoftimeve.

**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Ilirjan CELIBASHI**

